


AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME "KURUM INDUSTRIAL GASES" SH.A.

Sot me date 08.12.2006,

- z.Hasmet Kurum, shtetas turk, i dtl. 27.12.1960, lindur ne Van , Turqi, si perfadhesues dhe aksioner i vetem i "Kurum International sh.a" ,subjekt themelues i kësaj Shoqërie Anonime ne te cilen do te jete aksioner i vetem, vendosi te hartoje kete Akt Themelimi, mbeshtetur ne parimet e meposhtme:



NENI 1.

Themeluesi krijon nje shoqeri anonime te cilen do ta quaje **"KURUM INDUSTRIAL GASES" SH.A.**

Shoqeria do te jete e tipit Sh.A. pa oferte publike, per aq kohe sa Asambleja e Aksionereve nuk do te marre vendim per shnderrimin e saj ne Shoqeri Anonime me oferte publike ose ne cdo forme tjeter shoqerie te parashikuar nga Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"

Shoqeria do te jete Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2.

Emertimi i shoqerise eshte **"KURUM INDUSTRIAL GASES" SH.A.**

NENI 3.

Selia e shoqerise do te jete ne adresen Ish Kombinati Metalurgjik , Bradashesh, Elbasan. Ajo mund te ndryshoje seline e saj sipas percaktimeve te bera ne statut.

NENI 4.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e barazvlefshme me periudhen e marreveshjes se koncesionit te Fabrikes se Oksigenit Elbasan , miratuar me VKM nr. 594 dt.28.08.2003, (30 vjet nga data e hyrjes ne fuqi) , me perjashtim te rasteve kur shoqeria mbaron sipas percaktimeve ne ligj ose kur vendos Asambleja e Aksionereve.

NENI 5.

Objekti i Veprimtarise se shoqerise.

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

- Zbatimin e marreveshjes se koncesionit per shfrytezimin e Fabrikes se Oksigenit Elbasan, lidhur midi Ministrise se Industrise dhe Energjitikes, Ministrise se Ekonomise dhe shoqerise Kururm International sh.p.k , miratuar me VKM nr. 594 dt.28.08.2003.
- Prodhim, eksport-import, tregetim dhe shitje me shumice dhe pakice i gazrave teknike ne tregun e brendshem dhe te jashtem.

Shoqeria brenda hapesirave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi,do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se saj.

Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja, krijimin e siper marrjeve te reja dhe pjesemarrjen ne siper marrje te tjera, si brenda dhe jashte vendit, pa cenuar objektin e shoqerise.
Cdo shtim ose pakesim i objektit te veprimtarise do te behet sipas parashikimeve ne statut dhe ne te regjistracionin ne fuqi,

NENI 6.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.000.000 (dy milion) leke.

Ky kapital ndahet ne 100 (njqind) aksione me vlere 20.000 (njezet mije) leke secili.

Ky kapital zoterohet perkatesisht nga :

- **Shoqeria Kurum International sh.a** ka depozituar ne kohen e derdhjes ne banke te kapitalit Shumen prej 2.000.000 leke. Zoteron 100 % (Njqind perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, e barabarte me 100 (Njqind) aksione.

NENI 7.

Organet Drejtuese te Shoqerise jane :

- Asambleja e Aksionereve
- Keshilli Mbikqyres
- Drejtoria

NENI 8.

Keshilli i pare mbikqyres i shoqerise eshte :

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane:

1. Zeki Mehmet Kaya, shtetas turk i datelindjes 14.01.1956, banues ne Tirane-**KRYETAR**
2. Murat Mehmet Ali Gunerdi, shtetas turk, i datelindjes 27.03. 1978, banues ne Elbasan – **Zv.KRYETAR**
3. Haxhihasan Gani Saraci, shtetas shqiptar, i datelindjes 22.12.1951 , banues ne Tirane - **ANETAR**

Drejtori i pare i shoqerise eshte : Bunyamin Diricanli, shtetas turk i datelindjes 10.02.1964, me nr. pasaport TR-L 076005, banues ne Elbasan.

Menyra e emerimit dhe kopetencat e tyre percaktohen ne statutin e shoqerise.

NENI 9.

Emerimi i ekspertit kontabel

Ekspert i pare kontabel i autorizuar i shoqerise emerohet zoti Andon Taqo Kristo, datelindja 02.10.1948, banues ne Elbasan, me Licence te I.E.K.A nr. 5.

NENI 10.

Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise, rregullohen sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij Akt-Themelimi.

Investimet dhe veprimtaria e Shoqerise gezojne mbrojtjen e shtetit Shqiptar, i cili krijon te njejtat kushte si per subjektet shqiptare ashtu edhe ato te huaja.



NENI 11.

Fitimi i realizuar kalon ne pronesi te Aksionereve sipas perqindjes te ketyre aksioneve qe ata disponojne.

Fitimi eshte lirisht i transferueshem brenda edhe jashte shtetit shqiptar.

NENI 12.

Per kryerjen e aktivitetit te saj tregtar shoqeria mund te punesoje specialiste apo punetore vendas apo te huaj sipas rregullave perkatese. Marredheniet e punesimit do te rregullohen me anen e kontrates dhe brenda legjislacionit shqiptar.

Shoqeria mund te hyje ne marredhenie kontraktuale me subjekte te tjera brenda apo jashte vendit, duke u rregulluar keto marredhenie ne bazen e kontrates.

NENI 13.

Te punesuarit dhe te ngarkuarit me drejtimin e Shoqerise mbajne pergjegjesi dhe detyrohen te zhdemtoje Shoqerine per demet qe i jane shkaktuar per faj te tyre gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre.

NENI 14.

Aksioneret mund te vendosin me vullnetin e tyre,per pjesmarrjen ne Shoqeri te tjera dhe te krijojne cdo lloj aktiviteti tjeter privat.

NENI 15.

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se Shoqerise zgjidhen nga vete Aksioneret me ane te mirekuptimit dhe kompromisit dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente.Po keshtu mosmarreshjet midis te treteve dhe shoqerise si dhe midis shoqerise dhe personave te punesuar ne te,ne rast se nuk zgjidhen ne rrugen e mirekuptimit do te zgjidhen nga gjykata kompetente.

Gjykata kompetente per zgjidhjen e mosmarrveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 16.

Problemet e pa trajtuara ne Aktin e Themelimit apo te trajtuara shkurt do te zgjidhen gjithmone sipas kerkesave te ligjit baze "Per shoqerite tregtare".


NENI 17.

Akti i Themelimit pasi u lexua nga Themeluesit perpara Noterit,u nenshkrua prej tij pa verejtje.

Per shoqerine KURUM INTERNATIONAL S.H.A

Hasmet KURUM

Hasmet B. Kurum



S T A T U T I
I SHOQERISE ANONIME "KURUM INDUSTRIAL GASES" SH.A.

Ne baze te Akt-Themelimit si dhe ne zbatim te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" veprimtaria e shoqerise "KURUM INDUSTRIAL GASES" SH.A. do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti.

Shoqeria "KURUM INDUSTRIAL GASES" SH.A. krijohet nga aksioneri :
Shoqerie Anonime "Kurum International sh.a" me perfaqesues dhe aksioner te vetem z.
Hasmet Kurum, shtetas turk, i dtl. 27.12.1960, lindur ne Van , Turqi

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqeria "KURUM INDUSTRIAL GASES" SH.A. rregullon poziten e saj juridike, maredheniet e themeluesve, te organeve te saj, llojin e Shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj, maredheniet me te punesuarit, duke u bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar ne fuqi qe rregullojne maredheniet e Shoqerive Tregtare

NENI 1.

Forma e shoqerise

Shoqeria do te jete anonime, pa oferte publike, per sa kohe qe Asambleja e Aksionereve te Shoqerise nuk do te vendose per shendrrimin e saj ne shoqeri anonime me oferte publike apo ndonje forme tjeter te parashikuar nga ligji.
Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit 7638 "Per shoqerite tregtare", nga ky Statut dhe nga legjislacioni ne fuqi.
Shoqeria eshte person juridik dhe e ushtron aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jashte saj sipas parashikimeve ne legjislacionin shqiptar.
Kjo shoqeri fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

NENI 2

Emertimi dhe selia e shoqerise

Shoqeria regjistrohet me emrin "KURUM INDUSTRIAL GASES" SH.A.

Selia e Shoqerise ndodhet ne qytetin e Elbasanit me adrese : Ish Kombinati Metalurgjik, Bradashesh - Elbasan

Ne varesi te aktivitetit te saj tregtar shoqeria mund te hape dege, filiale apo zyra perfaqesimi te saj ne rrethe te ndryshme te vendit apo edhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin e tyre.

NENI 3.

Kohezigjatja

Kohezigjatja e shoqerise do te jete e barazvlefshme me periudhen e marreveshjes se koncesionit te Fabrikes se Oksigjenit Elbasan , miratuar me VKM nr. 594 dt.28.08.2003, (30 vjet nga data e hyrjes ne fuqi) , me perjashtim te rasteve kur shoqeria mbaron sipas percaktimeve ne ligj ose kur vendos Asambleja e Aksionereve.

NENI 4.

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj :

- Zbatimin e marreveshjes se koncesionit per shfrytezimin e Fabrikes se Oksigjenit Elbasan, lidhur midis Ministrise se Industrise dhe Energjitikes, Ministrise se Ekonomise dhe shoqerise Kururm International sh.p.k , miratuar me VKM nr. 594 dt.28.08.2003.
- Prodhim, eksport-import, tregetim dhe shitje me shumice dhe pakice i gazrave teknike ne tregun e brendshem dhe te jashtem.

Shoqeria brenda hapesirave te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi,do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e veprimtarise se saj.

Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive te reja,krijimin e siper marrjeve te reja dhe pjesemarrjen ne siper marrje te tjera,si brenda dhe jashte vendit,pa cenuar objektin e shoqerise.

Cdo shtim ose pakesim i objektit te veprimtarise do te behet sipas parashikimeve ne statut dhe ne legjislacionin ne fuqi,

NENI 5.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2.000.000 (dy milion) leke.

Ky kapital ndahet ne 100 (njqind) aksione me vlere 20.000 (njetzet mije) leke secili.

Ky kapital zoterohet perkatesisht nga :

- **Shoqeria Kurum International sh.a** ka depozituar ne kohen e derdhjes ne banke te kapitalit Shumen prej 2.000.000 leke.Zoteron 100 % (Njqind perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise,e barabarte me 100 (Njqind) aksione.

NENI 6.

Ndryshimet e kapitalit themeltar

I vetmi organ kompetent per ndryshimin e kapitalit eshte mbledhja e jashtezakonshme e Asamblese se Aksionereve e cila merr vendim ne baze te raportit te Drejtorise qe permban treguesit e kerkuar nga ligji .

Kapitali themeltar mund te zmadhohet me te gjitha menytrat dhe modalitetet e kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim.



Asambleja e Aksionereve eshte i vetmi organ qe vendos te zmadhoje ose te zvogeloje kapitalin e shoqerise dhe aksioneret kane te drejte ti permbahen ne proporcion me numrin e aksioneve ne pronesi te tyre.

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar do te kryhet konform dispozitave te Seksionit VI te breut te V me titull "Ndryshimi i kapitalit themeltar" te ligjit nr.7638 date 19.11.1993 "Per shoqerite tregtare"

NENI 7.

Aksioneret, te drejtat dhe detyrat e tyre

Aksioneret e shoqerise jane persona fizike ose juridike, qe kane ose do te kene ne zoterim aksione te shoqerise me te gjitha menytrat e parashikuara ne ligj dhe nga ky Statut. Zoterimi i aksioneve u jep te drejten atyre te marrin pjese ne Mbledhjen e Asamblese. Votat qe zoterojne aksioneret jane ne proporcion me perqindjen e aksioneve qe ata zoterojne.

Cdo aksioner ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shperndarshme te shoqerise, ne perputhje me aksionet e tij, sipas vleres nominale te zotuar prej tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e Aksionereve ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe nga ky statut.

Aksioneret jane pergjegjes per detyrimet dhe humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve te aksioneve qe zoterojne.

NENI 8.

Format e aksioneve dhe libri i aksioneve

Aksionet jane nominale.

Pronesia e aksioneve pasqyrohet ne librin e aksioneve, te mbajtur nga ana e shoqerise.

Libri i aksioneve duhet te permbaje per cdo aksioner : numrin dhe kategorine e aksioneve, daten e marrjes nga aksioneri, emrin, mbiemrin dhe adresen e cdo aksioneri si dhe vleren nominale per cdo aksion te zotuar.

Secili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga Libri i aksioneve, i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Secili aksioner ka te drejte te verifikoje nese emri i tij eshte regjistruar ne librin e aksioneve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar ti tregoje aksionerit me kerkesen e ketij te fundit, pasqyrimin perkates ne liber.

NENI 9.

Transferimi i pronesise se aksioneve

Aksionet e shoqerise jane te transferueshem.

Transferimet e aksioneve te shoqerise tek aksioneret e tjere apo te tretet, duhet te vertetohen me akt noterial, ndryshe jane te pavlefshme.

Ne rast tjetersimi te aksioneve cdokush prej aksionereve eshte i detyruar ti ofroje ato me pare per blerje aksionereve te tjere (e drejta e parablerjes). Vetem ne rast refuzimi nga ana e ketyre te fundit mbajtesi mund te disponoje lirisht tjetersimin e tyre.

NENI 10

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- 1.Asambleja e Aksioneve
- 2.Keshilli Mbikqyres
- 3.Drejtoria

NENI 11

Asambleja e Aksionereve

Asambleja e Aksionereve eshte organi me i larte i shoqerise.

Asambleja e Zakonshme

Asambleja e zakonshme merr te gjitha vendimet e percaktuara ne ligj ose nga ky Statut, me perjashtim te rasteve kur vendimet perfshihen ne kompetencat e Asamblese se Jashtezonshme.

Asambleja e Zakonshme thirret ne mbledhje te pakten njehere ne vit, Brenda 6-muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare, vetem neqoftese aksioneret e pranishem ose perfaqesuesit e tyre zoterojne $\frac{1}{2}$ e aksioneve me te drejte vote dhe ne mbledhjen e dyte $\frac{1}{4}$ e aksioneve me te drejte vote.

Asambleja e zakonshme merr vendime me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Cdo perfaqesues i aksionereve mund te votoje ne teresine e votave te ortakut qe perfaqeson.

Asambleja e zakonshme pergjithesisht ka keto kompetenca :

- Miraton plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
- Miraton, ndryshon ose hedh poshte llogarite vjetore qe i shtrohen per miratim.
- Miraton raportin vjetor te punes se kryer nga Drejtori i Shoqerise.
- Krijon dhe mbyll ndermarrjet si motra , deget, perfaqesite apo zyrat e perfaqesimit.
- Ben administrimin ekonomik te elementeve pasurore te shoqerise pas parashtrimit perkates te Drejtorise.
- Shet ose blen elementet pasurore te shoqerise dhe lidh marreveshjet me te tretet pas parashtrimit perkates te Drejtorise.
- Miraton cdo lloj garancie (hipoteke, pengu) te ofruar nga shoqeria ne formen e se drejtes te posedimit te pasurise se shoqerise si dhe te garancive te tjera qe kane te bejne me borxhet ne baze te legjislacionit ne fuqi.
- Emeron dhe shkarkon antare te Keshillit Mbikqyres, zevendeson antaret e papershtatshem dhe percakton shperblimin e tyre.
- Emeron Ekspertet kontabel te autorizuar.
- Vendos per shperndarjen e fitimit vjetor.

Asambleja e Jashtezakonshme.

Asambleja e jashtezakonshme e zhvillon mbledhjen e saj nese aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten 50% te aksioneve me te drejte vote. Ne qofte se perfaqesimi eshte me pak se 50%, thirret nje mbledhje e dyte.

Mbledhja e dyte zhvillon punimet kur aksioneret qe jane ta pranishemose te perfaqesuar zoterojne 25% te aksioneve me te drejte vote. Ne mungese te ketij quorumi, mbledhja e dyte e Asamblese mund te shtyhet per nje date tjeter, jo me larg se dy muaj nga data e thirrjes se pare. Asambleja merr vendime me shumice votash prej $\frac{3}{4}$ qe u perkasin aksionereve te pranishem apo te perfaqesuar.

Asambleja e Jashtezakonshme ka te drejte :

- Te ndryshoje Statutin.
- Te ndryshoje (zmadhoje ose zvogeloje) kapitalin.
- Te vendose per shenderimin e shoqerise ne nje forme tjeter.
- Te vendose per shkrijen ose mbylljen e shoqerise.

NENI 12

Thirrja e mbledhjes se Asamblese.

Asamblene e Aksionereve e therrasin :

1. Keshilli Mbikqyres
2. Drejtori

Ne mungese te Drejtorit ose kur nuk mblidhet shumica e Keshillit Mbikqyres, Asamblene mund ta therrasin :Eksperti kontabel i autorizuar, likujduesit ose nje mandatmbajtes i caktuar nga gjykata, me kerkese te cdo personi te interesuar per nje rast urgjent, ose te nje apo disa aksionereve qe zoterojne se bashku te pakten 10% te kapitalit themeltar.

Mbledhja e Asamblese thirret nepermjet lajmerimit qe botohet ne nje gazete te autorizuar per publikimin e njoftimeve ligjore.

Njoftimi behet edhe me leter rekomande ne adresen e cdo aksioneri, me shpenzimet e shoqerise. Njoftimi duhet te bjere ne dore te aksionerit apo te njihet prej tyre te pakten 15 dite perpara zhvillimit te mbledhjes. Ne njoftim percaktohen: vendi i mbledhjes, data dhe ora si dhe rendi i dites.

Rendi i dites se mbledhjes percaktohet nga autori i njoftimit. Asambleja nuk mund te shqyrtoje nje ceshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dites.

Rendi i dites nuk mund te ndryshohet ne njoftimin e dyte.

Cdo aksioner perfaqeson nje vote. Cdo aksioner mund te perfaqesohet nga nje aksioner tjeter i shoqerise,ose nga persona te tjere. E drejta e votes mund te ushtrohet me ane te nje prokure ose te nje autorizimi, sipas rastit.

NENI 13.

Drejtimi i mbledhjes

Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese te tij, Asambleja e zgjedh vete drejtuesin e saj.



Drejtuesi i Asamblese zgjedh nje sekretar. Procesverbali i mbledhjes duhet te firmoset nga drejtuesi, pjesemarrësit ne mbledhje dhe sekretari i mbledhjes.

NENI 14.

Keshilli Mbikqyres

Administrimi i shoqërise kontrollohet nga Keshilli Mbikqyres, i cili emerohet nga Asambleja e Aksionereve.

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare. Asambleja e Aksionereve mund te vendose per shtimin e numrit te antareve te keshillit Mbikqyres dhe te perberjes se tij. Koha e ushtrimit te detyres eshte 3 vjet per anetaret e caktuar ne Statut dhe jo me shume se 5 vjet per anetaret e emeruar nga Asambleja.

Ne qofte se nje anetar i Keshillit Mbikqyres emerohet anetar i Drejtorise, mandati i tij ne Keshillin Mbikqyres perfundon me kalimin e tij ne funksionin e ri.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te japin doreheqjen nga detyra me anen e nje deklarate e cila duhet ti dergohet Kryetarit te Keshillit Mbikqyres duke respektuar nje limit kohor prej dy javesh.

Keshilli Mbikqyres ka keto kompetenca :

- Emeron dhe shkarkon nga detyra anetaret e drejtorise dhe Drejtorin e shoqërise.
- Kontrollon Drejtorine e shoqërise per plotesimin e detyrave te saj.
- Ka te drejte te mbikqyre ne cdo kohe menaxhimin e shoqërise dhe dokumentacionin e nevojshem.
- Mund ti propozoje Asamblese ndryshime ne Statut, miratimin e raporteve ekonomike qe parashikon ligji, ndarjen e pjeseve te fitimit, lidhjen e marreveshjeve me te tretet
- Miraton regulloren e brendshme mbi funksionimin e shoqërise.
- Miraton, me propozimin e Drejtorise, rrogat dhe numrin e personelit.
- Therret ne raport Drejtorine, e cila per kete qellim pergatit nje raport qe mbulon aktivitetin e shoqërise, te pakten cdo tre muaj.

NENI 15.

Kryetari dhe Zv.Kryetari i Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjedh midis antareve te tij, nje Kryetar dhe nje zevendes kryetar. Ne qofte se Kryetari ose zevendesi i tij lirohen nga detyra para mbarimit te afatit do te kryhet nje zgjedhje tjeter per periudhen e mbetur. Ne pamundesi te ardhjes ne mbledhje te Kryetarit dhe zevendesit te tij detyrat do te kryhen nga anetari me i vjeter ne moshe

NENI 16.

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres

Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres thirren me shkrim nga Kryetari ose ne mungese te tij nga Zv.Kryetari. Lajmerimi behet te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes. Ne raste urgjente lajmerimi mund te behet gojarisht, me telefon, telegram, faks ose e-mail. Anetari shprehet per rregullsine e ketyre lajmerimeve ne procesverbalin e mbledhjes.

Ne lajmerim duhet te percaktohet rendi i dites.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te shtrojne ne mbledhje edhe ceshtje te tjera te cilat duhet ti behen te njohura me shkrim Kryetarit, te pakten 10 dite perpara mbledhjes. Te gjithë anetaret duhet te informohen per keto ndryshime.



Mbledhja e Keshillit Mbikqyres rregullisht behet ne seline e shoqerise, por mund te behet edhe ne vende te tjera ku Kryetari e shikon te arsyeshme.

Keshilli Mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem, ne qofte se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te Keshillit. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash. Ne rast votash te barabarta ajo e Kryetarit eshte percaktuese.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari dhe ne mungese te tij nga Zevendes kryetari.

Kryetari vendos radhen e rendit te dites, llojin dhe radhen e votimit.

Procesverbalet e mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres duhet te pergatiten dhe te nenshkruhen nga drejtuesi i mbledhjes dhe te pranishmit. Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne arkivin e shoqerise.

NENI 17.

Emerimi i anetareve te Keshillit te pare Mbikqyres

Anetaret e Keshillit Mbikqyres jane:

1. Zeki Mehmet Kaya, shtetas turk i datelindjes 14.01.1956, banues ne Tirane - KRYETAR
2. Murat Mehmet Ali Gunerdi, shtetas turk, i datelindjes 27.03. 1978, banues ne Elbasan - Zv. KRYETAR
3. Haxhihasan Gani Saraci, shtetas shqiptar, i datelindjes 22.12.1951, banues ne Tirane - ANETAR

NENI 18.

Drejtoria

Shoqeria drejtohet nga Drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare.

Numri i anetareve te Drejtorise caktohet nga Asambleja e Aksionereve.

Drejtori perfaqeson shoqerine ne marrdhenie me te tretet.

Anetaret e Drejtorise mund te perzgjidhen si brenda ashtu dhe jashte bashkesise se aksionereve. Ne rast se nje anetar i Keshillit Mbikqyres emerohet anetar i Drejtorise, mandati i tij ne Keshillin Mbikqyres perfundon. Anetaret e Drejtorise mund te shkarkohen vetem per shkaqe te perligjura.

Drejtor i pare i shoqerise emerohet z. Bunyamin Diricanli

NENI 19.

Kompetencat e Drejtorit

Drejtori ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e nenshkruara nga Drejtori i saj, per sa keto akte nuk vijne bien ndesh me interesat e shoqerise.

Drejtori ka te drejten te autorizoje persone te tjere per te nenshkruar akte ne emer te shoqerise.

Drejtori ben strukturen e organizimit teshoqerise te cilen e miraton Keshilli Mbikqyres.

Drejtori pergatit raportin e administrimit te shoqerise dhe ja paraqet Keshillit Mbikqyres.

Punon per zbatimin me saktesi te vendimeve te marra nga Asambleja e Aksionereve, organizon punen per realizimine objektit te veprimtarise se shoqerise.

Administron pasurine e shoqerise, duke perfshire mjetet financiare dhe kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise.



Perfaqeson shoqerine ne mbrojtjen e interesave te saj ne gjykata apo arbitrazh,ne banka apo cdo institucion tjeter nenshkruan kontrata ne emer te shoqerise dhe ndjek zbatimin e tyre.

Emeron dhe shkarkon punonjesit dhe nenshkruan kontrata kolektive dhe individuale me ta.

NENI 20.

Llogarite vjetore

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti.

Perjashtim perben vetem viti i pare financiar i cili perfshin kohën qe nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregetar deri deri ne 31 dhjetor te atij viti.

Shoqeria do ta mbaje kontabilitetin e saj sipas ligjeve ne fuqi.

Rezultati financiar del nga diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem.

Nga fitimi , hiqet 5% qe do te mbahet si rezerve legale e domosdoshme.

Kur rezervat legale arrijne 10% te kapitalit, mbajtja e rezervave shtese nuk eshte e detyrueshme.Shperndarja e fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me vendim te Asamblese se aksionereve.

NENI 21.

Emerimi i ekspertit kontabel te autorizuar

Ekspert i pare kontabel i autorizuar i shoqerise emerohet zoti Andon Taqo Kristo, datelindja 02.10.1948, banues ne Elbasan, me Licence te I.E.K.A nr. 5.

NENI 22.

Kontrolli kontabel

Shoqeria mban libra kontabel per te regjistruar te gjitha veprimet e saj ne baze te udhezimeve te pergjithshem kontabel qe veprojne ne Shqiperi.

Librat kontabel kontrollohen cdo vit nga eksperti kontabel i cili emerohet dhe vepron ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 23.

Marredheniet e punes

Marredheniet e punes ne Shoqeri rregullohen sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit e Kodit te Punes.

Per kryerjen e aktivitetit tregtar shoqeria mund te punesoje specialiste apo punonjes vendas apo te huaj sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Punesimi ne Shoqeri realizohet me ane te kontrates individuale te punes midis Shoqerise e te punesuaeve.

Marrdheniet midis Shoqerise e sindikates rregullohen nepermjet kontrates kolektive te punes.

NENI 24.

Kontrata e punes

Kontrata individuale e punes rregullon keto marrdhenie :



Marja ne pune, kushtet e te punesuarit per tu marre ne pune,lloji i punes qe do te kryeje i punesuari, profesionet ndihmese, koha e punes ditore e javore, pushimi ditor e javor, shperblimi per kohen e punes, per periudhen jashte kohes normale te punes, per punen e nates, per ditet e pushimit dhe te festave, shperblimi per pune te dalluar,pergjegjesite e paleve per mos respektimin e kontrates,etj.

NENI 25.

Pergjegjesia per demet

Te punesuarit dhe punonjesit, drejtuesit administrative jane pergjegjes per demet qe i shkaktojne Shoqerise per faj te tyre dhe pergjigjen para saj civilisht.

NENI 26.

Likujdimi i shoqerise

Likujdimi i shoqerise vendoset nga Asambleja e Jashtezakonshme e aksionereve. Procesi i likujdimit te shoqerise do te behet ne perputhje me Seksionin V te Kreut te VI te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

NENI 27.

Forca madhore

Aksioneret nuk mbajne pergjegjesi kur kane paaftesi pjesore apo te plote per kryerjen e detyrimeve te tyre dhe kjo eshte rrjedhoje e rrethanave te forcave madhore qe vertetohen pas marrjes se detyrimeve dhe aksioneret nuk mund tju shmangen me masa te arsyeshme. Pala e paafte per arsye te rrethanave te forces madhore eshte e detyruar te njoftoje me shkrim aksioneret e tjere.

Njoftimi duhet te permbaje kohen , natyren, permasat dhe vleresimin e ngjarjes se jashtezakonshme qe pengojne plotesimin e mire te detyrave nga ana e ortakeve sikurse percaktohen nga akti i themelimit dhe statuti.

Pala qe ndodhet ne paaftesi per te plotesuar detyrimet e saj per arsye e force madhore duhet te beje cdo perpjekje per kapercimine situates nga e cila rrjedh paaftesia.

NENI 28.

Dispozita te pergjithshme

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, vlejne dispozitat e legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

Statuti hyn ne fuqi mbas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane

AKSIONERI

Per KURUM INTERNATIONAL S.H.A

Hasmet B. KURUM
Hasmet KURUM

